

fq. 2 Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së,
takohet me përfaqësues të tregjeve të mbikëqyrrura dhe të mediave

VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-nëntor 2015 fq. 2

ZHVILLIME TË TJERA

- » Takim pune me drejtuesit e shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës fq. 4
- » Znj. Shehi përshëndet aktivitetin “Dita e Investitorit” fq. 4
- » Publikohet njoftimi i përgjithshëm i prokurimit për projektin “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”, financuar nga SECO fq. 4
- » Takimi i 7-të i Nënkomitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri për “Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat” fq. 5

LAJMET NGA RAJONI

- » Bosnje-Hercegovinë fq. 6
- » Gjeorgji fq. 6
- » Estoni fq. 7
- » Kroaci fq. 7
- » Rumani fq. 7

EDUKIMI I KONSUMATORIT

- » “E ardhmja e tregjeve të kapitalit në ekonominë dixhitale” fq. 8
Greg Medcraft, Kryetar i Komisionit Australian të Letrave me Vlerë dhe Investimeve të Australisë
(vijon nga numri i kaluar - pjesa e tretë)

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, takohet me përfaqësues të tregjeve të mbikëqyrura dhe të mediave

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, zhvilloi më datë 22 dhjetor 2015 një takim përmbyllës me drejtues të subjekteve të mbikëqyrura nga AMF, që operojnë në tregun e sigurimeve, të fondeve të pensioneve private vullnetare, letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve, si dhe përfaqësues të medias.

Znj. Shehi vuri theksin në sfidat e rëndësishme të vitit 2016, përkatësisht zbatimin e mbikëqyrjes me bazë rrezikun në të tre tregjet, të cilat i mbikëqyr dhe i rregullon AMF; nxitjen e qëndrueshmërisë në tregjet financiare nëpërmjet përmirësimit të procesit të mbikëqyrjes së konsoliduar; forcimin e punës së AMF-së në drejtim të mbrojtjes dhe edukimit konsumator.

Në përfundim Znj. Shehi vuri theksin në nevojën e përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe transparencës me konsumatorët, si dhe të edukimit e mbrojtjes konsumatore. Për përmbushjen e këtij misioni Znj. Shehi kërkoi më shumë vëmendje nga operatorët e tregjeve financiare në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimit dhe nga përfaqësuesit e medias për trajtimin e aspekteve që lidhen me tregjet financiare.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-nëntor 2015

Tregu i sigurimeve u rrit me 18.82% gjatë periudhës janar-nëntor 2015. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 12.4 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me rritje të numrit të policave të sigurimit me 6.31% duke arritur në 979,827 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 22.31% në krahasim me periudhën janar-nëntor 2014. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1.93 miliardë lekë, apo 61.83% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 21.31% gjatë periudhës janar-nëntor 2015, krahasuar kjo me periudhën janar-nëntor 2014.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 7.45 miliardë lekë gjatë periudhës janar-nëntor 2015, duke shënuar një rritje prej 21.67% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 60.17% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 15.83% të tregut të Jo-Jetës;
- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 12.48% të tregut të Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 5.23% krahasuar me periudhën janar-nëntor të vitit 2014. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitor” e cila përbën 65.27% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-nëntor 2015

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



ZHVILLIME TË TJERA

Takim pune me drejtuesit e shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, zhvilloi më datë 3 dhjetor 2015 një takim me Drejtorët e Përgjithshëm të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës.

Gjatë takimit Znj. Shehi kërkoi angazhim maksimal nga shoqëritë e sigurimit, për përmbushjen e detyrimeve të prapambetura të fondit të kompensimit, që burojnë nga mjetet e pasiguruara, sipas skedulit të miratuar nga Bordi i AMF-së. Njëkohësisht në takim u diskutua dhe mbi zhvillimet më të fundit, si ecuria e miratimit të projektligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, si dhe taksa e re që pritet të zbatohet mbi primin e sigurimit.

Znj. Shehi përshëndet aktivitetin “Dita e Investitorit”

Znj. Enkeleda Shehi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, përshëndeti në aktivitetin “Dita e Investitorit”, të mbajtur në datë 14 dhjetor 2015. Ky aktivitet organizohej nga Raiffeisen Invest, shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Në aktivitet merrnin pjesë investitorë të fondeve e investimeve, ekspertë të financave dhe përfaqësues të organizmave financiare të huaja.

Në fjalën e saj përshëndetëse, Znj. Shehi vuri theksin në përmirësimin e kuadrit rregullator për tregun e fondeve të investimeve. Znj. Shehi theksoi në veçanti ndryshimet rregullatore që lidhen me vendosjen e regjimit të administrimit të likuiditetit, vlerësimin e aseteve të fondit me vlerën e tregut, apo me regjimin e transparencës për investitorin.

Gjithashtu Znj. Shehi trajtoi zhvillimet e tregut të pensioneve private vullnetare, duke theksuar se nga natyra e zhvillimit të tij, ky treg është mjaft i ngjashëm dhe ndërthuret me tregun e fondeve të investimeve. Prandaj në rastin e Shqipërisë është e qartë se ka nevojë që zhvillimi i të dy tregjeve të nxitet së bashku.

Fjalën e plotë të Znj. Shehi mbajtur në aktivitetin “Dita e Investitorit” e lexoni në linkun poshtëshënuar

<http://www.amf.gov.al/files/File/Znj.%20Shehi%20pershendet%20aktivitetin%20Dita%20e%20Investitorit.pdf>

Publikohet njoftimi i përgjithshëm i prokurimit për projektin “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”, financuar nga SECO

Në faqen e Internetit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, seksioni për zhvillimin e biznesit, është publikuar njoftimi i përgjithshëm i prokurimit për projektin “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”, financuar nga SECO.

Njoftimin e përgjithshëm të prokurimit e lexoni në linkun poshtëshënuar:

<http://www.devbusiness.com/ProjectViewer.aspx?ProjectID=59836&ProjectType=1>

Takimi i 7-të i Nënkomitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri për “Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat”

Në datën 15 dhjetor 2015, në Bruksel u zhvillua takimi i shtatë i Nënkomitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri për “Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat”.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i zhvillimeve legjislativë dhe institucionale të Shqipërisë për çështjet ekonomike financiare, si dhe statistikën e vlerësimit nga pala evropiane i progresit të bërë nga Shqipëria në përmbushjen e angazhimeve që burojnë nga dokumentat strategjike si: MSA, partneriteti evropian 2007, rekomandimet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian 2014, si dhe angazhimet e ndërmarra në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2015-2020.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në kuadër të këtij takimi, hartoi raportin për tregun e fondeve të investimeve, duke u fokusuar në aspektin e zhvillimeve legjislativë e rregullatore, me qëllim përafrimin me *acquis* e BE-së, forcimin e mbikëqyrjes mbi veprimtarinë e fondeve të investimeve, si dhe ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.

Përfaqësuesit e AMF-së, pjesëmarrës në këtë takim, paraqitën në mënyrë të përmbledhur zhvillimet legjislativë në funksion të rregullimit ligjor të tregut të fondeve të investimit, i cili është gjithnjë në rritje, në funksion të një mbikëqyrjeje efektive të veprimtarisë së operatorëve të këtij tregu.

Zhvillimet legjislativë janë realizuar në përputhje me rekomandimet e misionit FSAP, i cili evidentoi si sfida kryesore për AMF-në:

- » Forcimin e regjimit të rregullimit të tregut të fondeve të investimit dhe forcimin e kapaciteteve të AMF-së për të mbikëqyrur këtë treg; si dhe
- » Nxitjen e zhvillimit afatgjatë dhe qëndrueshmërisë së tregut.

Ndër zhvillimet më të rëndësishme legjislativë u përmendën:

- » Vendosja e regjimit të administrimit të likuiditetit nëpërmjet hartimit të rregullores “Për administrimin e likuiditetit në sipërmarrjet e investimeve kolektive”;
- » Vlerësimi i aseteve të fondit me vlerën e tregut nëpërmjet ndryshimeve në Rregulloren nr. 77, datë 29.06.2011 “Mbi përcaktimin e vlerës së aseteve të sipërmarrjeve të investimit kolektiv dhe llogaritjen e vlerës neto të aseteve të tyre për kuotë ose për aksion”;
- » Regjimi i transparencës me investitorin nëpërmjet Rregullores “Për informacionin kryesor që duhet t’i vihet në dispozicion investitorit të skemave të investimeve kolektive”.

Përsa i përket forcimit të mbikëqyrjes së këtyre fondeve në takim u prezantuan midis të tjerave ndryshimet strukturore të AMF-së pas miratimit të Ligjit nr. 54/2014, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, sikurse është krijimi dhe funksionimi i Drejtorisë së “Mbikëqyrjes së tregut të fondeve të pensionit, të tregut të fondeve të investimit dhe të tregut të titujve”, pranë Departamentit të Mbikëqyrjes me punonjës të dedikuar për mbikëqyrjen e fondeve të investimeve. Gjithashtu u prezantua projekti i asistencës teknike për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse me fokus zhvillimin e tregut të kapitaleve (SECO) i mbështetur nga Banka Botërore dhe financuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike, projekt i cili ka në themel forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së për tregun e fondeve të investimeve dhe nxitjen e zhvillimit të tregut të obligacioneve të korporatave dhe të qeverisë vendore.

LAJMET NGA RAJONI

BOSNJE-HERCEGOVINË

www.xprimm.com

Bazuar në shifrat e dhëna nga agjencitë e sigurimit në Federatën e Bosnje-Hercegovinës (FBiH) dhe Republikës Serbe të Bosnjes (RS), në tremujorin e tretë të vitit 2015, vlera totale e primeve të shkruara bruto nga 24 sigurues aktive në dy njësitë administrative ishte 227.2 milionë euro, ose 4.4% më shumë sesa vitin e kaluar. Në tërësi, vlera e dëmeve të paguara u rrit me thajse 5% në krahasim me vitin e kaluar, duke arritur në 96 milionë euro.

Siguruesit nga Federata (FBiH) përfaqësuan rreth 70.6% të totalit të primeve ose 1.6% më shumë sesa vitin e kaluar, ndërkohë që tregu i sigurimeve të Republikës Serbe të Bosnjes gjeneroi pjesën e mbetur prej 66.7 milionë euro, me rreth 11.9% më shumë sesa vitin e kaluar.

Duke analizuar shifrat e tregut në total, portofoli i primeve të shkruara bruto përbëhej 20% nga sigurimi i Jetës (rreth 45.5 milionë euro) dhe 80% nga sigurimi i Jo-Jetës.

Ndër klasat e sigurimeve, rreth 10.7% e primeve i korresponduan sigurimit të pronës dhe 59% sigurimit motorik. Sigurimi motorik duke përfshirë sigurimin Kasko për mjetet motorike dhe MTPL, së bashku arritën një vlerë prej rreth 126 milionë euro.

GJEORGJI

www.xprimm.com

Sipas publikimeve nga Zyra e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Gjeorgji, në fund të muajit shtator të vitit 2015, industria e sigurimeve gjeorgjiane arriti një total prej 292 milionë GEL (monedha lokale) ose rreth 109 milionë euro. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2014, tregu i sigurimeve lokale u rrit me 29.4%, kryesisht për shkak të rritjes 94% të raportuar në segmentin e sigurimit të shëndetit.

Në totalin e primeve të shkruara bruto, rreth 44.5% e përbënin primet e sigurimit shëndetësor, 19.6% ato të sigurimit të pronës, 14.9% policat Kasko për mjetet motorike dhe 6.1% primet e sigurimit të Jetës. Pjesa e mbetur, rreth 15%, ishin prime nga klasat e tjera të sigurimit të Jo-Jetës.

Gjatë muajve janar-shtator 2015 siguruesit gjeorgjianë paguan dëme prej afërsisht 151.5 milionë GEL ose 56.7 milionë euro, nga të cilat më shumë se 62% lidheshin me klasën e sigurimit shëndetësor.

ESTONI

www.xprimm.com

Sipas publikimeve nga Bordi Estonez i Statistikave Kombëtare, siguruesit estonezë në fund të muajit shtator 2015 raportuan prime të shkruara bruto në një total prej 267 milionë euro, ose 5.4% më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Nga segmentet kryesorë të tregut, sigurimi i Jetës u rrit me 3.1% në krahasim me vitin e kaluar, duke arritur një vlerë të primeve të shkruara bruto 60.4 milionë euro. Në sigurimin e Jetës, 23 milionë euro u gjeneruan nga produktet e lidhura me skemat e investimeve. Sigurimi i Jo-Jetës arriti një total prej 206.7 milionë euro, ose 6% më shumë sesa vitin e kaluar.

Sipas shifrave të publikuara në faqen zyrtare të Bordit Estonez të Statistikave Kombëtare, ndër të gjitha kategoritë e sigurimit të Jo-Jetës, pesha më e madhe në primet e shkruara bruto u raportua nga dy klasat e sigurimit për mjetet motorike (sigurimi Kasko dhe TPL për mjetet motorike), të cilat gjeneruan së bashku afërsisht 123 milionë euro.

KROACI

www.xprimm.com

Zëdhënisi i konglomeratit të diversifikuar kroat Adris Grup ka deklaruar se planifikon që të listohet në bursat jashtë vendit në vitin 2018. Adris Grupa, i listuar në Zagreb, planifikon që të investojë më shumë se 4 miliardë Kuna, afërsisht 527.2 milionë euro, në periudhën 2016-2018 me qëllim që të rrisë vlerën e operacioneve të tij ekzistuese.

Sipas njoftimit të zëdhënësit të konglomeratit të diversifikuar kroat Adris Grup, synimi final i kompanisë së tij është listimi në Bursën e Londrës në vitin 2018 (<http://wire.seenews.com/news/croatias-adris-grupa-plans-listing-abroad-in-2018-499644>)

RUMANI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Rumanisë, tregu i sigurimeve u rrit me 7.6% në fund të tremujorin e 3-të vitit 2015, duke arritur në vlerën e 1.43 bilionë euro. Primet e shkruara bruto të sigurimit të Jetës u rritën me 9.46%, ndërsa ato të sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 7%, dhe kjo e fundit më shumë nga rritja e produkteve të sigurimeve motorike.

Në sigurimin e Jetës, megjithëse produktet e lidhura me investimet patën dinamikën më të lartë të rritjes, në terma absolute kontributin më të lartë në rritjen e primeve në sektorin e Jetës e kishin produktet tradicionale të sigurimit të Jetës me rreth 15 milionë euro. Në segmentin e sigurimit të Jo-Jetës, produktet motorike udhëhoqën tregun.

EDUKIMI I KONSUMATORIT

“E ardhmja e tregjeve të kapitalit në ekonominë dixhitale”

Fjala e mbajtur nga Greg Medcraft, Kryetar i Komisionit Australian të Letrave me Vlerë dhe Investimeve (Australian Securities and Investments Commission) me studentë dhe pedagogë në Universitetin Carnegie Mellon në Adelaide, Australia, 16 shtator 2015. Z. Greg Medcraft është gjithashtu edhe Kryetar i Bordit të Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) e cila mbledh së bashku rregullatorë të tregut nga më shumë se 120 juridiksione – të cilat përfaqësojnë mbi 90% të vlerës së tregjeve të kapitalit në botë.

Në fjalën e tij ai flet specifikisht për tre çështje: (i) Disa nga ndryshimet që sjellin teknologjitë dixhitale në modelet ekzistuese të biznesit; (ii) Mundësinë që këto zhvillime kanë për tregjet kapitale ashtu siç i njohim ato, duke ju referuar në mënyrë të veçantë emergjencës së teknologjisë së bazës së të dhënave; (iii) Mënyrën se si mund të përgjigjen rregullatorët.

(Pjesa III. Marrë me shkurtime)

(vijon nga numri i kaluar)

Si përgjigjen rregullatorët

Kam folur për mundësitë që ofron *blockchain*. Por, siç e thashë, këto mundësi mund të kërcënojnë gjithashtu prioritetet tona strategjike të besimit të investitorit dhe besueshmërisë për tregje të pastra, të rregullta, transparente dhe efikase.

Në këto momente ne nuk e dimë tamam se si do të zhvillohen *blockchain* ose teknologjitë e tjera. Por, dimë që ato do të zhvillohen. Ndoshta *blockchain* ka implikime të thella për tregjet tona dhe për mënyrën se si ne rregullojmë.

Si rregullatorë dhe politikëbërës, ne duhet të sigurojmë se ajo që bëjmë është e lidhur me shfrytëzimin e mundësive dhe përfitimet më të mëdha ekonomike – pa e penguar zhvillimin dhe risitë. Në të njëjtën kohë, ne duhet të zbusim risqet që paraqesin këto zhvillime për objektivat tona. Duhet gjithashtu të sigurojmë ata që përfitojnë nga besimi tek teknologjia e re. Ne punojmë për të siguruar që investitorët mund të vazhdojnë të kenë besim në treg.

Si përgjigjet ASIC sfidave të veçimit dixhital?

Roli i ASIC për të shfrytëzuar mundësitë, ndërkohë që zbusim risqet, shtrihet në pesë fusha kryesore:

» Së pari, arsimimi. Ne mbështesim investitorët dhe konsumatorët financiarë në njohjen e mundësive dhe risqeve të pjesëmarrjes në ekonominë dixhitale. Për shembull, faqja jonë zyrtare MoneySmart, vitin e kaluar pati më shumë se 5 milionë vizitorë;

» Së dyti, drejtimi. Ne jemi të angazhuar dhe po e udhëheqim industrinë në këto fusha;

» Së treti, survejimi. Ne monitorojmë tregun dhe kuptojmë se si investitorët përdorin teknologjinë dhe produktet financiare, si dhe risqet që lindin. Ne marrim përsipër skanime të vazhdueshme të peizazhit, duke përfshirë zhvillimet jashtë vendit, për të kuptuar më mirë zhvillimet e reja, ritmin e ndryshimit dhe risqet që mund të paraqiten nga ndryshimi strukturor i nxitur prej veçimit dixhital. Në rastin e

blockchain, ekziston nevoja që rregullatorët të fokusohen dhe të kuptojnë një varg çështjesh, duke përfshirë (i) mënyrën se si mund të rrezikohet siguria e *blockchain*; (ii) kush duhet të jetë përgjegjës për shërbimet që e bëjnë teknologjinë *blockchain* të funksionojë; (iii) mënyra se si transaksionet që përdorin *blockchain* mund të raportohen dhe shfrytëzohen nga rregullatori përkatës;

» Së katërti, zbatueshmëria. Sigurisht, aty ku ne zbulojmë veprime të gabuara nga kontrolluesit e aksesit, ne do të ndërmarrim veprime. Sfidat janë këtu do të jetë që të kuptojmë sesi mund të ndërmerret veprimi rregullator, varësisht nga vendi ku transaksioni regjistrohet në *blockchain*, brenda ose jashtë vendit;

» Së pesti, këshillimi mbi politikat. Sigurimi që në zbatim janë rregullat e duhura, me synim për të mbrojtur investitorët dhe për t'i mbajtur ata të informuar dhe me mirëbesim, por pa ndërhyrë me pengesa në risitë teknologjike.

*Ne duhet të sigurojmë gjithashtu që rregullat janë të qëndrueshme në nivel global dhe rregullatorët mund të mbështeten tek njëri-tjetri në mbikëqyrje dhe në zbatimin e këtyre zhvillimeve. Ne do të vazhdojmë të shqyrtojmë kuadrin rregullator aktual, të analizojmë sesi zhvillimet e reja, siç është *blockchain*, mund të përshtaten dhe të identifikojnë se ku mund të jenë të nevojshme ndryshimet.*

Si po përgjigjet IOSCO

IOSCO ka gjithashtu një rol në këtë fushë, në mënyrë të veçantë për të siguruar që ekziston një strategji globale në zbatim. IOSCO siguron bashkëpunimin ndërmjet rregullatorëve për të përmbushur sfidën e adresimit të çështjeve që lindin nga transaksionet ndërkufitare. Plani i punës së IOSCO-s këtë vit në këtë fushë përfshin katër prioritetet që vijojnë:

» Punën për të identifikuar dhe kuptuar risqet që rrjedhin nga veçimi dixhital në modelet e biznesit;

» Hapësirën e politikave ndërkombëtare. Kjo lidhet me hartimin e paketave rregullatore dhe përgjigjeve që janë fleksibël, krijuese dhe japin stimuj për risi të teknologjisë financiare që nxisin zhvillim pa çenuar besimin e investitorëve dhe konsumatorëve financiarë në tregjet tona. Një shembull i kësaj është puna që ne po marrim në konsideratë për financimin masiv nga shumë investitorë me sasi të vogël secili, (*crowdfunding*).

» Hapësirën e *cyber resilience* apo *elasticiteti kibernetik*. Ne po punojmë me Komitetin për Pagesa dhe Infrastrukturat e Tregut për të zhvilluar udhëzime që do të ndihmojnë në fuqizimin e *cyber resilience* të ndërmjetësve të tregut financiar. Ne presim që këto udhëzime të finalizohen vitin tjetër.

» Fuqizimin e bashkëpunimit. Ne po punojmë për përmirësime në Memorandumin shumëpalësh të Mirëkuptimit të IOSCO-s, MMOU, për t'u përballur me mjedisin e ri teknologjik në të cilin operojmë. MMOU është një bashkëpunim që u mundëson 105 rregullatorëve të shpërndajnë informacione për të luftuar mashtrimet ndërkufitare dhe veprimet e gabuara. Këto përmirësime do ta bëjnë më të lehtë për ne që të ndërmarrim veprime në lidhje me transaksionet ndërkufitare.

Konkluzione

Dëshiroj që ta mbyll, duke theksuar rëndësinë e industrisë dhe rregullatorëve që punojnë së bashku për të shfrytëzuar mundësitë e veçimit dixhital dhe inovacionit financiar. Ne dëshirojmë ta ndihmojmë industrinë që të përfitojë nga mundësitë që ofrohen, qofshin nga teknologjia e *blockchain* ose risi të tjera. Por, sigurisht, ne dëshirojmë gjithashtu inovacionin që kujdeset për besimin dhe konfidencën e investitorit dhe konsumatorit financiar.

Si rregullator, ne do të vazhdojmë të shohim përpara në zhvillimet e reja. Të gjithë ne kemi interesin e përbashkët, që të shohim rezultatin e këtyre mundësive, duke zbutur në të njëjtën kohë risqet, në mënyrë që të gjithë të gëzojmë përfitimet e besimit në tregjet tona dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

(Fund)

Cyber resilience është aftësia për tu përgatitur dhe përshtatur ndaj ndryshimit të kushteve përballimit sa më të shpejtë duke u kthyer në gjendjen e mëparshme. *Cyber resilience* përfshin aftësinë për t'i bërë ballë dhe për tu rikuperuar nga sulmet e qëllimshme, aksidentet, kërcënimet apo incidentet.